

CONCEPTUAL METAPHORS IN THE ALBANIAN POLITICAL DISCOURSE AND THEIR MEANING

Xhyla ÇELIKU

University of Tetova, Faculty of Law, Political Sciences
gjyla.celiku@unite.edu.mk

Gjuliano ISEINI

University of Tetova, Faculty of Philology, German Language and Literature
gjuliano.iseini@unite.edu.mk

Arbër ÇELIKU

University of Tetova, Faculty of Philology, German Language and Literature
arber.celiku@unite.edu.mk

UDC 811.18'373.612.2

UDC 811.276.1:32

Professional paper

Abstract

The aim of this article is to analyze the conceptual metaphors in the Albanian political discourse and its reception in the public. The notion of ‘conceptual metaphors’ is relatively new in the linguistics, it has started with Lakoff and Johnson: *Metaphors we live by* (1980). In the Albanian language there are few works about conceptual metaphors: Arbër Çeliku has committed some research according to this topic, comparing the Albanian with the German language (2009) and Albanian with the English language (2013).

The metaphorizations in the concept level are very productive in the Albanian language, especially the politicians seem to use them very cleverly, and they use them as a weapon against the opponents and the critical thinking. The corpus of this article contents political speeches, declarations of different politicians, texts from different online Albanian platforms, etc. Analyzing all this, we have classified the conceptual metaphors in different typologies as: conceptual metaphors they content idioms, lexemes with a mythological background, somatic lexemes, etc.

Key words: *Conceptual metaphors, metaphorization, political discourse, somatic lexems.*

1. Hyrje

Synimi i këtij punimi është të trajtojë metaforat konceptuale, duke u nisur nga ndërtimi i tyre gjuhësor, funksioni dhe përdorimi i tyre në diskursin politik, me theks të veçantë në atë shqiptar.

Metaforat kanë qenë një mjet i shprehjes poetike qysh në Greqinë antike dhe i pari, i cili e ka përdorur nacionin ‘metaforë’ është Aristoteli në veprën e tij *Poetika*. Kështu, që dymijë vjet nacioni ‘metaforë’ qëndron për kuptimin e nëntëshëm, të bartur, figurativ dhe merret si një mjet kryesor i njërit ndër kriteret bazë të tekstualitetit sipas Dressler-it (1981), koherencës. Sipas Çelikut (2009:19) “koheranca garanton marrëdhëniet semantike-logjike të tekstit” dhe ai (po aty, fq.24) e ndan atë në: Koherencën A (eksplicite) dhe Koherencën B (implicite). Realizimi i koherencës A apo eksplikite ndodh natyrshëm, mjaftojnë vetëm njohuritë gjuhësore dhe perceptimi normal mbi realitetin objektiv, kurse për t'u realizuar Koheranca B apo implicite, nevojitet njohja e kontekstit jashtëgjuhësor, njohuritë specifike mbi një fushë të caktuar, deshifrimi i të folurit ironik dhe diplomatik, etj.

Metaforizimet, sidomos ato konceptuale bëjnë pjesë në grupin e koherencës B të tekstit dhe shpesh deshifrimi i tyre është i vështirë, shumëkuptimor, por edhe lajthitës, siç do ta shohim në hulumtimin empirik të këtij punimi. Megjithatë, fillimisht ta elaborojmë nacionin e metaforës konceptuale, që të kemi një shikim sa më të qartë për problemin studimor.

2. Metaforizimet konceptuale

Me këtë rast nuk synohet të bëhet një trajtim teorik i metaforave, sepse ato tashmë janë të bjerra në literaturën shkencore. Për hulumtimin në fjalë, është e rëndësishme, që një fjalë apo shprehje gjuhësore paraqet një metaforë, kur bartja e një apo më shumë tipareve të një elementi A ndodh mbi një element B. Që bartja e një elementi të funksionojë, nevojitet të realizohet një relacion ngjashmërie, një *tertium comparationis* si njësi krahasimi. Në diskurset politike, më së shumti krahasohen elementet e kafshëve, pjesëve të trupit, që në literaturën shkencore njihen me termin ‘somatizma’ dhe barten si veti të politikanëve. Psh. luani si implikatura ka: fuqinë dhe trimërinë dhe kështu rezultojnë metaforizimet ‘trim si luan’, ‘i fuqishëm si luan’, ‘zemërluan’, etj. Pra, pjesë të mëdha të përbërjes frazeologjike bazohen në një krijim metaforik, sidomos në rastin e metaforave konceptuale (për një studim të metaforave konceptuale shih A. Çeliku 2009 dhe 2013).

Metaforizimet e këtilla në diskursin politik, së fundmi, kanë marrë një hov të madh të përdorimit dhe shpërfaqin modele të ndryshme të komunikimit të politikanëve me publikun e gjerë, duke mëtuar të dëshmojnë për nivelin e tyre të lartë intelektual dhe të aftësisë së tyre të

politikëbërjes. Metaforat konceptuale, nga ky grup individësh shfrytëzohen edhe si armë për të mposhtur rivalët e tyre politikë, por edhe për të amortizuar kritikat e shpeshtuara nga opinioni publik.

Gjatë metaforizimeve konceptuale, autorët Lakoff dhe Johnson (1980:6) pohojnë se fushat metaforike e drejtojnë procesin e njohjes (kognicionin), pra njohjen mbi botën, duke u bazuar në gjuhën angleze si në rastin e shembullit të tyre *Argument is war* (shq. argumenti është luftë), megjithatë gjuha shqipe mund të zhvillojë fusha të ndryshme metaforike, gjë që nënkupton se ajo zhvillon edhe struktura të ndryshme njohëse. Pra, kognicioni apo njohja nuk e drejton gjithmonë gjuhën, siç pohojnë autorët e lartpërmendur, por gjuha në raste të caktuara mund ta drejtojë procesin njohës, duke pasur parasysh implikaturat kulturore, traditat, doket dhe zakonet, por edhe zhvillimin specifik te gjuhës së përditshme nga folësit e një rajoni të caktuar, të cilat rezultojnë me metaforizime të tipave të ndryshëm, specifike për atë gjuhë.

Në këtë kontekst Çeliku (2009 dhe 2013) hulumtimet e tij në fushën e metaforave konceptuale i ka vënë në raport me gjuhën gjermane dhe angleze dhe rezulton se secila nga këto gjuhë dëshmon për një veçanti të metaforizimeve konceptuale, për më tepër, shqipja krijon fusha metaforike, të cilat janë të patrësportueshme në gjuhën gjermane dhe atë angleze. Shembujt e dhënë e dëshmojnë më së miri këtë: *Ai është kopil djalë*, ku fjala ‘kopil’ në gjuhën shqipe ka një kuptim negativ, pra një fëmijë i dalë nga një marrëdhënie jashtë martesore, por në këtë kontekst të caktuar nxirren në pah tiparet pozitive, të një personi të shkathët, dhe lind një metaforë konceptuale me kuptim pozitiv, e cila po kur transferohet në gjuhën gjermane apo angleze është një sintagmë e thjeshtë gjuhësore, pra nuk krijon aspak një fushë metaforike: gjerm. *er ist ein uneheliches Kind* dhe angl. *He is an illegitimate child*.

Metaforizime të këtilla ka mjaft në gjuhën shqipe, që në transportimin në gjermanishte dhe anglishtë, por edhe në gjuhët e tjera të botës rezultojnë vetëm si sintagma të thjeshta gjuhësore. Në rastin tonë, metaforizimet e tillë konceptuale do t'i trajtojmë më tej, konkretisht do të merremi me ndërtimin dhe funksionin e tyre në diskursin politik shqiptar, i cili, njëjtë si metaforat konceptuale, dukshëm ndryshon nga shoqëritë e tjera, duke pasur parasysh implikaturat gjuhësore dhe kulturore tonat, të cilat krijojnë fusha specifike në përdorimin e metaforave konceptuale në diskursin politik.

3. Metodologja

3.1. Ndërtimi i korpusit të të dhënave

Për të pasur një pasqyrë më të qartë të gjendjes së përdorimit të metaforave konceptuale në diskursin politik, kemi vjelë burime gazetash dhe të mediumeve online, fjalime politikanësh, debate televizive, kolumna të opinionistëve të ndryshëm nga bota shqipfolëse si dhe në konsideratë janë marrë biseda të rastit me përfaqësuesit e klasës politike.

Një tjetër burim i të dhënave është edhe Fjalori thesar i Gjuhës Shqipe (2006) prej të cilit janë shqyrtuar në mënyrë shteruese leksemat e ndërtimit metaforik në raport me rastet përkatëse të përdorimit në diskursin politik.

Materiali i shfrytëzuar nga burimet e sipërpërmendura na krijoi mundësinë për të ndërtuar një tipologji të përdorimit të metaforave konceptuale në diskursin politik shqiptar.

3.2. Paraqitja e rezultateve të hulumtimit

Nga analiza e korpusit të të dhënave të mbledhura, rezulton se tipologjia e metaforizimeve konceptuale në diskursin politik përfshin më shumë fusha jetësore. Fillimisht, politikanët në diskursin e tyre përdorin dendur *frazeologjizma* si: proverba, idioma, gojëdhëna. Shembujt e mëposhtëm do ta ilustrojnë këtë:

- 1) Shefi i grupit parlamentar të PDK-së, Adem Grabovci tha sot pas mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit se shqiptarët nuk duhet lejuar që të përdoren si **mish pér top** pas ngjarjeve të Kumanovës [...]

(Klan Kosova, versioni online, 12 maj 2015)

- 2) “Ne e presim Biden me **bukë, kripë e zemër**”, ka pohuar zv-ministri i punëve të jashtme të Kosovës, Valon Murtezaj [...]

(KlanKosova, versioni online, 16 gusht 2016)

- 3) A po **bën** Zejdi **petulla pér vete?**

(Flaka, versioni online, 11 janar 2018)

- 4) “Na lodhën “partiotat” e BDI-së duke u shitur shqiptarëve **dushk pér gogla**, ka pohuar Zejdi [...]

(TV Shenja, versioni online, 29 prill 2017)

Në shembullin 1, frazema **mish për top** krijon një metaforë konceptuale dhe tematizon **flijimin**.

Frazema **bukë, kripë e zemër**, një shprehje kjo mjaft e përdorur dhe e cila ka një traditë të lashtë në gjuhën shqipe, në shembullin e dhënë përdoren si metaforë konceptuale për **mikëpritjen e ngrohtë dhe miqësore**.

Në gjuhën shqipe, frazema **bën petulla për vete** e ka kuptimin kur dikush është egoist dhe mbron interesin e vet, në këtë funksion është edhe titulli mediatik në shembullin 3.

Frazema **dushk për gogla** si metaforë konceptuale në diskursin politik, si në shembullin e dhënë (4), tematizon **mashtrimin, impenjimin dhe manipulimin**.

Siç po shihet pra në shembujt e dhënë (1-4), kemi një tematizim të njësive frazeologjike në diskursin politik, të cilat të thënës, në radhë të parë, i jasin një fuqi si shprehëse ashtu edhe stilistikore.

Shpesh edhe leksema të caktuara qoftë nga mitologja, tradita, kuzhina dhe gjuha e përditshme, rezultojnë të marrin rolin e metaforave konceptuale në diskursin politik. Për ilustrim do të na shërbejnë shembujt e mëposhtëm:

- 5) Rama: PD si **gogol** [...]

(Dailymotion, versioni online, 4 gusht 2018)

- 6) Kryeministri Edi Rama, njihet për raportin e tij jo të mirë me mediat dhe gazetarët, pasi kohët e fundit ai ka filluar që t'u thotë **kazan** dhe të pa aftë [...]

(Panorama, versioni online, 8 nëntor 2017)

- 7) Lindim Etemi: Politikanë **plehra**, haku i fëmijëve do t'ju zërë

(Info shqip, versioni online, 28 tetor 2016)

- 8) Ishte plotësisht ironike sepse dje të gjithë pamë ata që për shumë kohë u lodhën së thirruri më kot se janë **shenjtorët** e votës së lirë [...]

(Panorama, versioni online, 7 gusht 2012)

Siç mund të vërejmë në shembujt e mësipërm (5-8), leksema të caktuara në një kontekst të dhënë metakomunikues krijojnë metafora të fuqishme konceptuale. Kështu, leksema **gogol** (shembulli 5), në fjalorin e shqipes së sotme (2006) sqarohet kësisoj: “Figurë e përrallave dhe e besimeve të kota, që përfytyrohet si një qenie e tmerrshme, me të cilën trembin fëmijët që të

mos qajnë e të rrinë urtë”, që nënkupton se implikatura bazë e gogolit është ‘ngjallja e frikës’. Edi Rama me deklaratën e tij dëshiron të thotë se PD-ja ngjall frikë, pra është diçka e tmerrshme.

Për leksemën **kazan** fjalori i shqipes jep këto përkufizime:

1. Enë e madhe prej metali (zakonisht prej bakri), e rrumbullakët dhe me dy veshë, që shërben për të zier ujë, ndërresa, gjellë etj.
2. tek. Pjesë e kaldajës, e lokomotivës etj., që përbëhet nga një enë e mbyllur e metaltë, ku prodhohet avull uji ose përpunohet diçka në temperaturë të lartë.
3. keq. Vendi ku zhvillohet vazhdimit një veprimtari e ethshme, ku zien lufta e mendimeve etj.; vendi ku përpunohet një mendim për të mashtruar të tjerët, burimi nga lind dhe përhapet një trillim, një shpifje etj.

Edi Rama mjeshtërisht e ka përdorur kuptimin nën 3 të kësaj lekseme, për ta projektuar atë në rrafshin metakomunikues, duke krijuar kësijoj një metaforë konceptuale: **mediumet si kazan**, që rezulton se ato janë burim shpifjeje, mashtrimi dhe manipulimi (shembulli 6).

Edhe në shembullin 7, nga leksema **pleh**, janë marrë implikurat negative dhe janë projektuar në rrafshin metakomunikues, duke krijuar një metaforë konceptuale: **politikanët si plehra**, në kuptiminividë pa vlerë, vrastarë të së ardhmes.

Leksema **shenjtor** fillimin origjinar e ka në diskursin fetar dhe në verte bart implikatura pozitive: pafajësi, dëlirësi, paprekshmëri, etj. Në shembullin e dhënë, në raport me politikanët, ajo krijon një metaforë konceptuale në kundërshtim me kuptimin e vërtetë që bart në vete, që nënkupton se **shenjtorët e votës së lirë** rezultojnë **mashtrues ordinerë** dhe **abuzues të votës së lirë**.

Ndër tipat më të shpeshtë të metaforave konceptuale në diskursin politik dalin togfjalëshat me bazën emërore të emërtimit të kafshëve. Në vazhdim do të japim disa shembuj për ta ilustruar këtë:

9) Është si Kali i Shemës [...]

(shembull i rikonstruktuar)

10) Gomari i Babatasit

(Titulli i poemës së Gjergj Fishtës)

11) Langonjtë titistë [...]

(shembull i rikonstruktuar)

Në njërën nga bisedat midis dy politikanëve shqiptarë në Maqedoni, të incizuara në mënyrë ilegale dhe të prezantuara nga opozita maqedonase gjatë viteve 2014-16, dëgjohet se si ata flasin për një bashkëpartiakun e tyre, kuptohet duke e përqeshur atë. Ata e përbyllin bisedën për të duke e karakterizuar si **Kali i Shemës**. Thuhet se ky kalë, i cili ka qenë i njëfarë Shemadini, shkurt Shema, nga Zajazi i Kërçovës ka qenë noprani dhe nuk ka pranuar t’ia vënë shalën, prandaj dhe i është rritur shumë prapanica. Metafora konceptuale është si **Kali i Shemës**, në këtë rrafsh metakomunikues jep këto implikatura: X politikan është noprani, X politikani i intereson vetëm rritja e prapanicës së tij, pra është egoist dhe interesxhi. Metafora konceptuale **Kali i Shemës** (shembulli 9) sot është njëra ndër më viralet në rrjetet sociale dhe sa herë që politikani në fjalë jep ndonjë deklaratë, postimi nga mediumet me imazhin e tij përbushet me komente negative, të shoqëruara edhe me fotografi kuajsh të ndryshëm.

Gomari i Babatasit titullohet poema e famshme e Gjergj Fishtës, e shkruar në vitin 1923. Metaforat konceptuale me leksemën **gomar** shfaqin implikaturat e njeriut të trashë nga mendja, budallait dhe në këtë kontekst Gjergj Fishta ka metaforizuar politikanët me gomarin, duke krijuar një metaforë konceptuale: **politikanët si gomarë** (shembulli 10).

Gjatë një bisede me një politikan shqiptar në Maqedoni, për kundërshtarët e tij politikë ai u shpreh: **Ata janë langonj titistë**. Në fjalorin e shqipes së sotme për leksemën *langua* jepen këto përkufizime:

1. Qen me trup të zhđervjellët, me këmbë të gjata e me turi të hollë, që është i shpejtë dhe që gjuan mirë.
2. fig. Njeri i shkathët e i mprehtë, që i nuhat shpejt gjërat.

Pavarësisht se leksema **langua** në fjalorin thesar të shqipes nuk përmban në vete asnjë implikaturë negative, në kontekstin e dhënë u krijuar një metaforë konceptuale me përbajtje të kundërt, në kuptimin se ata janë politikanë që merren me jetën e tjerëve. Edhe mbiemri **titist** në këtë rast tematizon një ideologji tashmë të dështuar, kështu metafora konceptuale: **langonj titistë** (shembulli 11) lë të kuptosh se bëhet fjalë për një shtresë politikanësh që karakteristikë të tyren kanë **dredhinë, manipulin, pabesinë** dhe **spiunimin**.

Si metafora konceptuale dalin edhe somatizmat, që njihen si metaforizime, të cilat përbazë kanë pjesë të trupit. Përmes shembullit të mëposhtëm do ta ilustrojmë këtë:

- 12) Porosia e Blerim Rekës për votuesit e BDI-së: Votoni me ndërgjegje dhe me **zemër!**

(INA, versioni online, 15 mars 2019)

Figurativisht leksema zemër shpreh ndjenjën, dashurinë, mirësinë, humanizmin. Duke qenë se partia shqiptare në pushtet Bashkimi Demokratik për Integrin (BDI) ka mbështetur publikisht kandidaturën e një kandidati maqedonas për president të shtetit, z. Blerim Reka, i cili është i vetmi kandidat shqiptar për president në Maqedoninë e Veriut, u bën thirrje votuesve të BDI-së që të votojnë me ndërgjegje dhe zemër, që me këtë rast po krijohet një metaforizim në rrafshin konceptual që ata të votojnë me dashurinë për të afermin, për gjakun e njëjtë.

4. Përfundime

Në këtë punim u trajtua nocioni i metaforës konceptuale dhe përdorimi i saj në diskursin politik. Gjuha shqipe, duke qenë një gjuhë e lashtë dhe e pasur me shprehje frazeologjike, krijon një korpus të gjerë të metaforizimeve konceptuale dhe, si rrjedhojë, edhe një tipologji të pasur të këtyre formave shprehëse qoftë në komunikimin e përditshëm ashtu edhe në diskursin politik. Ndër tipat më të përdorura janë metaforat konceptuale me bazë frazeologjike, tematizimet e ndryshme me leksema nga mitologjia, gojëdhënat, tradita si dhe leksemat që karakterizojnë pjesë të trupit, somatizmat, etj.

E mira është që përmes metaforizimeve konceptuale, sidomos në diskursin politik, kontribuohet në prurje të reja gjuhësore formale dhe kuptimore, të cilat njëkohësisht e pasurojnë gjuhën shqipe.

Trajesa në fjalë duhet të merret si një kontribut fillestar në fushën e metaforizimeve konceptuale në diskursin politik, por që hulumtimet mund të shtrihen edhe në fusha të tjera dhe të krijohet një korpus i gjerë i metaforizimeve konceptuale në gjuhën shqipe, i cili do t'u shërbejë gjeneratave të reja të gjuhëtarëve, politologëve, juristëve, etj. për thellime të mëtejshme në këtë fushë.

5. Bibliografia

- ÇELIKU, A. (2009): *Herstellung von Textkohärenz im Deutschen und im Albanischen*. PETER LANG Frankfurt am Main, Berlin, Bern, Bruxelles, New York, Oxford, Wien.
- ÇELIKU, A. (2013): “Realisation of text coherence in English and Albanian language through conceptual metaphors”. In: Research on Humanities and Social Sciences, New York, London, vol..3, Nr. 11, fq. 175-178.
- LAKOFF G./JOHNSON M. (1980): *Metaphors we live by*. Chicago and London: University of Chicago Press.